



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 257, datë 5.5.2021

PËR

**PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË ZBATIMIT  
TË LEGJISLACIONIT TË ASISTENCËS SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale përfshin kontrollin e programit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, që bëhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, bazuar në metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike, shtojca nr.1, dhe metodologjinë e kontrollit të vlerësimit bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar, shtojca nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror, bazuar në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar në shtojcat nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi.
3. Kontrolli i njësive të vetëqeverisjes vendore nga strukturat përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror në nivel rajonal bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar në

shtojcat nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi.

4. Programi i kontrollit të përbajë:

- a) subjektet që do të kontrollohen;
- b) llojin e kontrollit që do të ushtrohet;
- c) periudhën për të cilën do të bëhet kontrolli;
- ç) objektivat që duhet të realizohen.

5. Kontrolli programohet për çdo muaj. Kontrolli të jetë i plotë ose tematik, sipas analizës së riskut. Në çdo rast, përpala kryerjes së kontrollit, subjekti njoftohet me shkrim për fillimin e kontrollit, qëllimin, si dhe objektivat që do të realizohen. Kontrolli nga struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, në nivel qendror ose rajonal, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel qendror kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet për strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, duke zbatuar metodën me përzgjedhje, në bazë të analizës së riskut, kryen kontolle tematike për veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- b) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kontolle tematike, sipas analizës së riskut, në përputhje me programin e kontrollit, të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

6. Kontrolli mund të jetë i paparalajmëruar në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

7. Sinjalizime konsiderohen:

- a) njoftimet me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë vlerësuar si abuziv nga struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar;
- b) njoftimet ose ankimet e çdo forme nga entet publike;
- c) raportet specifike të gjeneruara nga sistemi.

8. Grupi i kontrollit në nivel qendror ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike për:

- a) veprimtarinë e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, me përgjedhje, të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike;
- b) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, duke kryer me përgjedhje, sipas analizës së riskut, kontolle tematike;
- c) procedurën e kryerjes së verifikimeve automatike në drejtoritë rajonale, nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike dhe verifikimeve manuale;
- c) procedurën e trajtimit të mospërputhjeve nga verifikuesit në drejtoritë rajonale ardhur nga ndërveprimi i sistemeve automatikisht me AKPF, DPT, ISSH, DPGJC, ASHK dhe në raste kur ka përgjigje nga institucionet që dërgohen manualisht;
- d) refuzimet e procedurën e vendimmarrjes së drejtorive rajonale për familjet aplikuese dhe përfitueset të ndihmës ekonomike;
- dh) performancën e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në kryerjen e kontrollit të ndihmës ekonomike në njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:
  - i. cilësisë së projektraportit referuar zbatimit të hapave të përcaktuar në metodologjinë e kontrollit;
  - ii. ndjekjes së zbatimit të detyrate të lëna lidhur me shpërblimin e dëmit dhe raportimin 6-mujor pranë Shërbimit Social Shtetëror;
  - iii. analizës së riskut të kontrollit tematik në njësitë vendore.

9. Grupi i kontrollit të strukturave rajonale ushton kontroll për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike për:

- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës për ndihmën ekonomike;
- b) dokumentacionin e procedurën e kryerjes së aplikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike, si dhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të ndihmës ekonomike;
- c) dokumentacionin e kategorive përfitueset të ndihmës ekonomike dhe afatin e vlefshmërisë së përfitimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) kryerjen e verifikimeve social-ekonomike nga administratorët shoqërorë, afatet dhe pasqyrimin e tyre në sistem;
- d) përputhshmërinë e deklarimit të familjes përfitueset me vizitën në shtëpi, të pasqyruar nga administratori shoqëror në sistem, nëpërmjet realizimit të verifikimeve social-ekonomike me përgjedhje;
- dh) familjet që kanë rezultuar me deklarim të rremë dhe afatin e përjashtimit

të tyre nga përfitimi i ndihmës ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi;

- e) deklarimet 3-mujore të ndryshimit të situatës social-ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, duke verifikuar gjenerimin e deklaratave 3-mujore në sistem me deklaratat 3-mujore në dosjen fizike me firmat e anëtarëve madhorë;
- ë) aplikimet e familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtar, person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo përfitues i kategorisë “individ” të ndihmës ekonomike;
- f) procedurën e ndjekur ndërmjet bashkisë dhe postës/bankës për rakordimin dhe marrjen e informacionit për listën emërore të familjeve që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike brenda afatit, si dhe ndjekjen e procesit të largimit të familjes nga përfitimi i ndihmës ekonomike;
- g) përputhjen ndërmjet borderosë dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike;
- gj) saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;
- h) mënyrën e planifikimit të fondit të ndihmës ekonomike dhe plotësimin e të dhënave statistikore, sipas legjislacionit në fuqi;
- i) procedurat e dokumentacionin e shpërndarjes së pagesave të ndihmës ekonomike për familjet që mbështeten me fondin deri në 6 (gjashtë) %, në bazë të kritereve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- j) dokumentacionin dhe pagesat e kompensimit të energjisë elektrike për familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

10. Për shkelje të legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin e menaxhimin e mashtimit dhe korruptionit, mbledhja e informacionit objektiv, të besueshëm, të saktë, në mënyrë sistematike dhe në kohë reale, bëhet sipas mekanizmit të standardizuar të raportimit për monitorimin e abuzimeve dhe korruptionit në skemën e ndihmës ekonomike, sipas shtojcës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Grupi i kontrollit në nivel qendror dhe rajonal ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara për:

- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësitë administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për pagesën e aftësisë së kufizuar;
- b) dokumentacionin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në dosjen fizike të përfituesit;
- c) përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të përfituesve dhe shumave të përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar;
- ç) saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

- d) mënyrën e planifikimit të fondit të pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi.
12. Për vlerësimin bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar, grapi i kontrollit në nivel qendror kontrollon zbatimin e legjislacionit për:
- a) kriteret, dokumentacionin e procedurën e kryerjes së aplikimeve në regjistrin elektronik, si dhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të aftësisë së kufizuar;
  - b) përputhshmërinë e diagnostikimit sipas kritereve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar me kriteret e vlerësimit bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët në qarqet ku aplikohet ky vlerësim;
  - c) kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë kontrollin e kartelës shëndetësore, përputhshmërinë e diagnozës dhe kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike;
  - ç) kontrollin e dosjeve fizike dhe elektronike të paraqitura për vlerësim/rivlerësim;
  - d) kontrollin në regjistrin analistik lidhur me regjistrimin dhe afatet e respektuara sipas akteve nënligjore;
- dh) procedurën e vendimmarrjes për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar nga komisioni shumëdisplinor në përputhje me nivelin e aftësisë së kufizuar.
13. Për vlerësimin bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar, grapi i kontrollit të strukturave rajonale ushton kontroll për:
- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësitë administrative, për përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuar;
  - b) dokumentacionin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në dosjen fizike të përfituesit dhe vlefshmërinë e tij;
  - c) zbatimin e legjislacionit nga ana e administratorit shoqëror në hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisplinor të vlerësimit;
  - ç) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se një herë në tre muaj;
- dh) përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të përfituesve dhe shumave të përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar, duke iu referuar edhe Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.
14. Grapi i kontrollit harton projektraportin për kontrollin e kryer dhe një kopje

ia dorëzon subjektit të kontrolluar, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, i paraqet subjektit kontrollues vërejtjet apo kundërshtitë, nëse ka, të argumentuara me dokumentacionin përkatës.

15. Raporti përfundimtar i kontrollit bëhet nga grupi i kontrollit, i cili vlerëson vërejtjet apo kundërshtitë e subjektit të kontrolluar dhe jep argumentet përkatëse në raport.

16. Titullari i institucionit ia paraqet raportin përfundimtar:

- a) kryetarit të bashkisë;
- b) prefektit të qarkut;
- c) drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror;
- ç) drejtorit rajonal të Shërbimit Social Shtetëror;
- d) drejtorit rajonal të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, për kontrolllet e ushtruara sipas pikës 12, të këtij vendimi; dhe
- dh) drejtorit të përgjithshëm të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.

17. Në raportin përfundimtar evidentohen të gjitha shkeljet e konstatuara nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, si më poshtë vijon:

- a) Masë disiplinore për shkelje nga strukturat rajonale të shërbimit social, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, administratori shoqëror pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, mjekët e familjes dhe mjekët specialistë;
- b) Gjobë, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, në rastet kur vërehet që shkeljet janë kryer në mënyrë të përsëritur;
- c) Shpërblimin e dëmit nga administratori shoqëror dhe/ose familja dhe/ose punonjësi i strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe/ose mjeku i familjes/specialist, nëse konstatahet se është shkaktuar dëm ekonomik;
- ç) Kallëzim penal, në rast se dyshohet se janë konsumuar elementet e veprës penale.

18. Vendimi nr.566, datë 29.9.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore", shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## K R Y E M I N I S T R I

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU